

UDHA ISLAMIE

Viti XII - Nr. 4 (134), Prill, 2014

E përnuajshme Informativ - Fetare - Kulturore - Edukative

Botim i Myftinisë Shkodër

KOHA PËR TË MOS U BËRË PALË ME HESHTJEN..!





Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

E mocionet që përjetohen kur nisesh për të vizituar historinë e 59408 shehidëve të Çanakkalesë, në mesin e të cilëve edhe shumë shqiptarë nga të gjitha trevat shqipfolëse, janë krejt legjitime. Janë emocione që përjetohen duke lexuar e parë nga afër historinë e besimtarëve që i dhanë fund, me fundin e jetës së tyre, historisë së kolonizimit kundër lirisë dhe besimit të popujve. Është historia e mposhtjes së përpjekjeve kryqtare për të minuar kalifatin shumëshekullor, rrënjët e të cilit ujitën te Resulull-llahu (a.s)...

“I plagosur rëndë Hasan efendiu, një burrë i moshuar, në shtratin e betejës tetë mujore, i kërkoi disa prej atyre që e asistonin, ta ngrinin në këmbë. Të habitur nga insistimi i tij, ata e ndihmuan të realizonte kërkesën e tij. “Zahmet ja Resulull-llah”- thërret i moshuari. “Do vija unë tek ti me shpirtin tim!”... dhe Çanakkalesë i shtohet edhe një shehid që largohet ëmbëlsisht nga kjo botë, në shoqërinë e Resulull-llahut (a.s)”. Kjo histori e të shumta të ngjashme me të, në gojën e ciceronit të grupit tonë, më bënë ta dua edhe më shumë shpirtin e Çanakkalesë dhe sinqeritetin e rreth 60 mijë shehidëve të rënë në mbrojtje të besimit, nderit, fesë, tokës, dinjitetit njerëzor...

Historia e Çanakkalesë¹ (1915)

1. Çanakkaleja është qytet i shkullit të XV, i themeluar në kohën e Sulltan Fatih Mehmetit. Sipas statistikave të vitit 1991 drejtuar nga D.I.B. (Komuniteti Musliman

ÇANAKKALE

ATY KU FJALA "SHEHID" MBETI KRYEFJALË...

Kujtime, Pendik, 21 qershor 2008

është kompetencë e historianëve të aftë, të cilët analizojnë stacionet e ndryshme të saj dhe japin mesazhet e duhura që mbart në vetëvete historia tetë mujore e përbaljes së gjallë në mes forcës së besimit dhe arrogancës së paganizmit, dritës së qytetërimit dhe errësirës së injorancës. Megjithatë, në këto rreshta do të ndalem në disa stacione që hasen krejt natyrshëm gjatë vizitës së gjallë në historinë e trupëzuar të këtij vendi.

1. Objekti i parë me të cilin u prezantuam që në hapat e parë të vizitës tonë në Çanakkalenë e famshme, ishte një përmendore me Turk), në Çanakkale ndodhen gjithsej 742 xhami.

Sulmi i parë i Ngushticës i njohur në literaturën perëndimore si “Luftërat e Gallipolit”, filloi më 3 nëntor të vitit 1914. Dy anije luftarake angleze bombarduan qendrat Ertuğrul dhe Seddülbahir, ndërsa dy anijet luftarake franceze bombarduan qendrat Kumkale dhe Orhaniye. Ky ishte edhe shkaku i fillimit të luftës, e cila edhe pse nuk ishte shpallur zyrtarisht, ky veprim aludonte se qëllimi i sulmeve detare do të ishte Ngushtica. Më 5 nëntor 1914 Franca dhe Anglia do t’i shpallin zyrtarisht luftë Perandorisë Osmane.

Kjo luftë e cila përfundoi me disfatën e Fuqive të Bashkuara (Francë dhe Angli) do të ndryshonte vazhdimësinë e Luftës së Parë Botërore, ashtu sikurse do të përgatiste rënien e Rusisë cariste dhe ndryshimet në shtetin anglez.

Në luftën e Çanakkalesë e cila la gjurmë në historinë botërore dhe zgjati për më shumë se një vit (3 Nëntor 1914 - 9 Janar 1916) morën pjesë 410.000 ushtarë anglezë dhe 79.000 ushtarë francezë. Vetëm në radhët e ushtrisë angleze, numri i të vrarëve ishte 213.980. Ndërsa në kampin tjetër morën pjesë rreth 700.000 ushtarë të forcave turke ndër të cilët 213.882 ishin të rënë.

Zekeriya Kurşun, Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi, botimi i parë, İstanbul 1993, vëll. i VIII, fq. 205-208. (përktheu nga turqishtja dhe përshtati në shqip, Elona Sytari).

masa të konsiderueshme (aq sa për t’u quajtur rëndomtë, e madhe) në zemër të së cilës ishte gdhendur një kryq i madh. I përkiste të rënëve anglezë në këtë vend!

Në të vërtetë, personalisht, nuk e kisha menduar përbaljen me këtë objekt (aq më tepër me kryqin e gdhendur në zemër të tij), jo për vetë objektin sesa për mendimin e thjeshtë se na ishte thënë që do vizitonim shehidët e ymmit, dëshmorët e teuhidit! Por, ja që në këtë “fushë-betejë” historike dikush kishte toleruar që edhe pushtuesve agresorë t’u ngrihej një përmendore, në mënyrë që njerëzit e tyre (në Evropë e jashtë saj) të dinin se edhe për ta ka një cak, i cili quhet Çanakkale! Caku i një agresori në prehërin e madh të një populli e një ymmit me besim të madh e kulturë hyjnore, me qytetërim të lashtë e tolerancë unike në botë!

Një obelisk i ngjashëm me atë të anglezëve, por shumëfish më i lartë e më madhështor (pa objekte fetare të gdhendura), në majë të një kodre, qëndronte ai i pushtuesve të rënë nga Zelanda. Tutje, edhe francezët e kishin një të tillë... Subhanall-llah, kaderi hyjnor i kishte bashkuar këta njerëz, në këtë vend, në dy pozita krejtësisht të kundërta, njëkohësisht dëshmitarë të gjallë, por të heshtur, të dy realiteteve të ndryshme besimore, qytetëruese e kulturore, pjesë e historisë njerëzore...

2. Përbalje pllakës së kristaltë, mbi të cilën ishin shënuar emrat e qyteteve dhe shteteve prej ku kishin ardhur ushtarët-shehidë muslimanë, si dhe numri përkatës i të rënëve nga secila kombësi, qëndrova i heshtur, por i mahnitur. Lexoja: Adana, Ankara,

Bengazi (Libi), Dibra² (Arnavutluk³), Dijarbekir, Drama⁴ (Junanistan⁵), Elbasan⁶ (Arnavutluk), Bulgaristan⁷, Gaza (Palestinë), Kejlan (Iran), Girit⁸ (Junanistan), Haleb⁹ (Siri), Halilurrahman¹⁰ (Palestinë), Hama¹¹ (Siri), Hixhaz¹² (Arabi Saudite), Hurean¹³ (Siri), Istanbul¹⁴, Iskodra¹⁵ (Arnavutluk), Izmir¹⁶, Kalkandelen¹⁷ (Maqedoni), Kerbela¹⁸ (Irak), Kerkuk¹⁹ (Irak), Kirim²⁰ (Ukrainë), Konja²¹, Kosova²², Kostence²³ (Rumani), Kudus²⁴ (Palestinë), Lazikije (Siri), Manastir²⁵ (Meqedoni), Mitrovicë²⁶ (Kosova), Prizren²⁷ (Kosova), Sakiz²⁸ (Junanistan), Samsun²⁹, Sana³⁰ (Jemen), Tebriz³¹ (Iran), Trablus³² (Libia), Trablus³³ (Lubnan³⁴), Uskup³⁵ (Maqedoni), Varna³⁶ (Bulgaristan), Vidin³⁷ (Bulgaristan), Vuçiternë³⁸ (Kosova), Jafa³⁹ (Israil), Gjakova⁴⁰

2. Një shehid.

3. Shqipëri.

4. Dy shehidë.

5. Greqi.

6. Një shehid.

7. Bullgari.

8. Gjashtëmbëdhjetë shehidë.

9. Pesëqind e katërdhjetë e tre shehidë.

10. Gjashtë shehidë.

11. Njëzet shehidë.

12. Tetë shehidë.

13. Horan. Dhjetë shehidë.

14. Një mijë e nëntëqind e katërdhjetë e dy shehidë.

15. Shtatëmbëdhjetë shehidë nga Shkodra.

16. Një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë shehidë.

17. Shtatë shehidë.

18. Një shehid.

19. Katër shehidë.

20. Dy shehidë.

21. Dy mijë e tetëqind e nëntëdhjetë shehidë.

22. Gjashtëdhjetë e tre shehidë.

23. Dy shehidë.

24. Pesëdhjetë e tre shehidë.

25. Tridhjetë e shtatë shehidë.

26. Një shehid.

27. Gjashtë shehidë.

28. Njëzet e dy shehidë.

29. Pesëdhjetë e katër shehidë.

30. Dy shehidë.

31. Një shehid.

32. Pesëmbëdhjetë shehidë.

33. Tetëmbëdhjetë shehidë.

34. Liban.

35. Njëzet e shtatë shehidë.


36. Një shehid.

37. Dy shehidë.

38. Një shehid.

39. Dhjetë shehidë.

40. Një shehid.



(Kosova), Janja⁴¹ (Arnavutluk), etj. Shënoheshin pjesëmarrës nga **141** vende, ose **59408** shehidë!⁴²

E në atë mori të madhe emrash e numrash, sytë e mi u përqendruan edhe te shënimi: **Iskodra (Arnavutluk)** dhe numri i shehidëve të rënë: **17** djem të rinj (kryesisht)!

Emocion i veçantë, i papërjetuar më parë! Mendo, 17 të rinj muslimanë nga qyteti im që kishin dhënë jetën e tyre të shtrenjtë për mbrojtjen e besimit dhe nderit të një ymeti të tërë! 17 djem të rinj nga vilajeti i Shkodrës që

41. Trembëdhjetë shehidë.

42. Ciceroni i grupit (njëkohësisht edhe imam xhamie në një zonë të afërt me Exhabatin) tregonte se numri i vërtetë i shehidëve të Çanakkalesë ishte i panjohur, edhe për faktin se shumë prej të rënëve nuk ishin identifikuar asnjëherë. Kjo do të thotë se 59408 është numri i shehidëve të identifikuar, por jo numri përfundimtar i të rënëve në këtë betejë të gjatë!

ishin shuar, atje larg, në Çanakkale për të mbrojtur lirinë e popujve kundër mizorisë së kolonizatorëve, kundër shkelësve të lirisë së besimit, kundër një ozurpatori shumë të fuqishëm materialisht, por shumë mjeran e meskin nga ana shpirtërore e qytetëruese! E shpirti i madh i besimit të muslimanëve të rinj shkodranë, por jo vetëm, thuri lavdinë e një populli, lavdinë e një ymeti, lavdinë e një historie plot lavdi!

Rahmete e lutje të sinqerta për këta mbrojtës të denjë të lirisë, besimit, nderit e tokës!

3. Pavarësisht sipërfaqes së madhe të zonës që po vizitonim, ku ishin përzier gjurmët origjinale të tuneleve të llojllojshme e llogoreve të shumta, me obelisqet, përmendoret,

pllakat përkujtimore e memorialet, numri i vizitorëve të shumtë në çdo cep të saj, nuk kishte se si të mos të tërhiqte vëmendjen!

Gjithandej grupe të rinjsh, më të rritur, të moshuar. Ciceronët nuk pushonin. Aparatet e ndryshme që fotografonin të zotët e tyre, kishin kohë që nuk ndalonin. Pak më tutje, shitësit e shumtë pas kjoskave të mirësistemuara ishin në aktivitet të pandërprerë. Me pak fjalë, në Çanakkale, edhe pse kishte dekada që beteja tetëmuajore e vitit 1915 kishte mbaruar, vendi akoma gumëzhinte dhe gjallëronte. Vizitorët ishin të panumërt! Ishin turqë, anglezë, ishte grupi ynë⁴³ me rreth 25 vetë, grupe të panumërta...

Mendova, me tërë këtë vapë (temperatura i kalonte 35 gradë, ndërkohë që dielli e kishte kaluar zenitin), megjithë largësinë dhe rrugën e gjatë nga Stambolli (por edhe përtej tij), të gjithë kishin një dëshirë të lexueshme në sjelljen e tyre, për ta vizituar këtë vend! Ta preknin, ta fotografonin, të fotografoheshin në vendet e shumta historike të tij!

Të gjithë kishin dëshirë që nesër, pasi të ishin kthyer në vendet e tyre, pranë të dashurve e dashamirëve, të thonin: “Edhe unë e kam vizituar Çanakkalenë! Edhe unë isha atje...!”

PARA PËRMENDORES SË TË RIUT SHKODRAN HASAN HAXHIA...

“Shkodran, shkodran...!”, thirri njëri prej anëtarëve të grupit tonë. Kaq ishte e mjaftueshme që emocionet të ndizeshin edhe më shumë, në atë vend, ku vetëm emocionet nuk mungojnë. Janë prezente më shumë se asnjëherë tjetër, më fuqishëm, më

43. Në këtë vizitë, grupin tonë e drejtonte dr. Durak Pasmaz, pedagog i tefsirit në Qendrën e Studimeve Pasuniversitare Haseki, në Pendik të Stambollit. Ai ishte një burrë fjalëpak, i zbardhur nga vitet dhe nga studimet. Mustaqet e bardha ia shtonin edhe më shumë prezencën prej një studiuesi serioz, i karakterizuar edhe nga durimi e dashamirësia ndaj tjetrit.



pranë zemrës e ndërgjegjes!

“Iskodra- Hacıoğlu Hasan- Doğum: 1895- 20 yaşında”! Ky është shënimi i gdhendur në përmendoren e shehidit 20 vjeçar nga Shkodra, Hasan Haxhia, i lindur në vitin 1895!

Në mesin e pllakave të panumërta prej mermeri, përmendore të disa prej të rënëve në Çanakkale, ndodhej edhe i riu Hasan nga Shkodra.

Nuk mund ta fshija dot emocionin që m’u krijua kur e lexova emrin e shehidit dhe prejardhjen e tij..., ishte qyteti im, qyteti ynë (i Hasan Haxhisë dhe imi), një lidhëse e fortë shtesë që më bënte të ndjeja për të respekt, nderim, pse jo dhe krenari për të dhe për vete! Ndjeja krenari për të, sepse i ishte paracaktuar të ishte prej shehidëve të këtij ymeti, një dëshmi e madhe që nuk e arrin kushdo e kurdo në jetë! Krenari për vete, pasi ndodhesha para përmendores së një shehidi, me të cilin, përveç lidhjes kryesore besimit e fesë, më lidhte edhe një element shtesë, vendlindja!

Për pak minuta, të bëhet se ai është aty përballë teje, të buzëqesh me nurin e shehidit dhe të tregon

për atë moment fatlum të marrjes së dëshmisë së dëshmorit në rrugën e mbrojtjes së besimit, fesë, nderit, tokës, ymetit... Të bëhet se Hasan Haxhia, me shpirtin e tij të pastër, është aty para syve të tu duke të rrëfyer episodet kryesore të betejës, së cilës i dhuroi edhe më të shtrenjtën gjë në jetë, shpirtin! Të bëhet se Hasan Haxhia, me përkujtimin e tij të shtrenjtë e madhështor, qëndron burrëror (edhe pse është i ri, me martirizimin e tij ia ka kaluar burrave!), e shikon përtej horizonteve, nga Shkodra e tij e dashur, të cilën e braktisi në emër të besimit, e së cilës iu kthye shehid... Ndonëse, vitet që pasuan martirizimin e tij, ishin të errëta, të hirta, të zizuara nga hijet e femohimit (ku doemos mohohet çdo vlerë e lidhur me besimin) për Shkodrën e krejt Shqipërinë, sot, emri i Hasan Haxhisë mori dimensione që e tejkalojnë periudhën e heshtjes dhe të harresës së emrit të tij... Hasan Haxhia, me shpirtin dhe kujtimin e tij, iu rikthye Shkodrës burrë, trim, besimtar, shehid...

E lumja Shkodër për shehidin e saj!
E lumja Shkodër për shehidët e saj!

Mëshira e All-llahut qoftë mbi Hasan Haxhinë dhe vëllezërit e tij të rënë në Çanakkale, si mbrojtës të denjë të besimit e dinjitetit njerëzor! Mëshira dhe begatia e All-llahut qoftë mbi heronjtë e besimit islam, në mesin e të cilëve edhe shehidi shkodran Hasan Haxhia...

(Pjesë nga shënimet e mia në dorëshkrim, me titull: “Sevelim, sevelelim...”

nga udhëtimi në Turqi, 16-22 qershor 2008, me një grup imamësh dhe myftilerësh të KMSH.)

Ky material botohet për herë të parë, pa ndryshime.

Shkodër, më 18 mars 2014, në 99 vjetorin e triumfit në Ngushticën e Dardaneleve.

PROMOVOHET LIBRI: "DËSHMITAR NË SAHAR..."

Pasditën e së xhumasë, më 21 mars 2014, Myftinia Shkodër ka organizuar promovimin e librit më të ri nga Imam Muhamed Sytari, titulluar: "Dëshmitar në Sahar...".

Në fjalën e tij të hapjes, teologu Arben Halluni ka vlerësuar këtë botim si një përkujtim i vlefshëm për Umren një javore, të kryer në mars të vitit të kaluar nga një grup imamësh dhe besimtarësh shkodranë, drejt vendeve të shenjta.

Ai ka theksuar se emocionet dhe kujtimet e rreshtuara në këtë libër, janë njëkohësisht edhe një memorie për ato ditë të begata të kaluara në një frymë adhurimi dhe harmonie islame të mrekullueshme.

Më pas, Imam Muhamed Sytari, ka rrëfyer para të pranishëmve për shkëndijën e parë që shkaktoi ndezjen e emocioneve dhe përshpirtjes, për shkrimin e këtij libri, që përmbledh kujtimet dhe refleksionet e një jave të kaluar në Mekë dhe Medine.

Myftiu ka falënderuar njëkohësisht edhe pjesëtarët e grupit, për të cilët ka shprehur mirënjohjen dhe vlerësimet e tij, për ditët e kaluara në harmoni besimi. Ai ka shprehur mirënjohje edhe për biznesmenin Sait Fishta, të cilin e ka konsideruar si një shembull të besimtarit dhe njeriut të përkushtuar për të dhënë në dobi të komunitetit dhe vlerave të besimit.

Për kënaqësinë e të pranishëmve, autori ka lexuar edhe një pjesë nga libri i tij, duke theksuar se emocionet e përjetuara, sidomos përballë malit të shpellës Hira, janë të papërshkrueshme dhe njëkohësisht të mbushin me dritë besimi dhe angazhim në shërbim të Thirrjes Islame.



H. FEJZI ZAGANJORI, MBI PARANDALIMIN E GJAKMARRJES



Mbrëmjen e së hënës, më 24 mars 2014, H. Fejzi Zaganjori, imam i xhamisë Rus, ka marrë pjesë në një bashkëbisedim të organizuar në emisionin "Shqip", të gazetares Rudina Xhunga, në Tv Top Channel, në lidhje me fenomenin e gjakmarrjes.

Gjatë këtij bashkëbisedimi, përfaqësuesi i Myftinisë së Zonës Shko-

dër, H. Fejzi Zaganjori, ka hedhur dritë mbi rëndësinë që ka në Islam, mbrojtja dhe respektimi i jetës së njeriut dhe mbjellja e frymës së harmonisë dhe bashkëjetesës në mesin e individëve të shoqërisë. Në këtë drejtim, ai i është referuar ajeteve të ndryshme kur'anore dhe haditheve profetike, që na thërrasin përherë e më shumë drejt këtyre mësimëve të shenjta.

Imami i nderuar, ka theksuar se Myftinia Shkodër, nëpërmjet aktivitetit të saj dhe thirrjeve të herëpashershme, ka dhënë kontributin e saj në rrugën e parandalimit të këtij fenomeni vrashtar. Në këtë drejtim, - ka theksuar H. Fejzi Zaganjori, - Myftinia Shkodër ka zhvilluar tryeza dhe takime për të analizuar shkaqet dhe pasojat e fenomenit të gjakmarrjes, në rrugën e angazhimit për të zgjidhur këtë ngërç shoqëror.

H. Fejzi Zaganjori, ka vlerësuar njëkohësisht edhe bashkëpunimin e komuniteteve fetare në kuadër të dhënies së një kontributi maksimal për pajtimin e njerëzve, afrimin e familjeve në hasmëri dhe eliminimin maksimal të fenomeneve që marrin jetë njerëzish.

H. Fejzi Zaganjori është një aktivist i hershëm i Myftinisë Shkodër në fushën e pajtimit të gjaqeve dhe kontributet e tij në këtë drejtim janë të shumta dhe të suksesshme.



المشورة الإسلامية الألبانية
 دار الإفتاء - مدينة شكوذرا
 KOMUNITETI MUSLIMAN I SHKODËR
 MYFTINIA SHKODËR

MYFTINIA SHKODËR JU FTON TË BËHENI PJESË E CIKLIT TË LIGJËRATAVE FETARE:

21 prill 2014 - Xhamia Perash

Tema: "Mirësjellja në jetën e myslimanëve".

Ligjërues: Teologu Gilman Kazazi dhe teologu Lavdrim Hamja.

22 prill 2014 - Xhamia e Medresesë

Tema: "Vlera e kohës tek dijetarët myslimanë".

Ligjërues: Teologu Arben Halluni dhe Imam Muhamed Sytari.

23 prill 2014 - Xhamia Bardhej

Tema "Vëllazëria dhe solidarizimi në mesin e myslimanëve".

Ligjërues: Teologu Adem Pizga dhe teologu Ervil Kuçi.

28 prill 2014 - Xhamia Rus

Tema "Namazi dhe dua ja në jetën e myslimanit".

Ligjërues: Teologu Idmir Plaku dhe teologu Durim Kasemi.

29 prill 2014 - Xhamia Tophanë

Tema "Falënderimi dhe mirënjohja në jetën e besimtarit".

Ligjërues: Imam Muhamed Sytari dhe teologu Ruzhdi Plangaj.

30 prill 2014 - Xhamia Golem

Tema "Përkushtimi i sahabeve në fe".

Ligjërues: Teologu Lavdrim Hamja dhe teologu Naim Drijaj.

(LIGJËRATAT ZHVILLOHEN PAS NAMAZIT TË AKSHAMIT)



Shejkh Muhamed El-Gazali

Ndjej se mes bijve të vendit tim ka një "krizë shpirtmadhësie" që nuk njihej kurrë më parë! Nëse hajduti dikur u vidhte diçka kalimtarëve, njerëzit e tjerë e kapnin për fyti, ia jepnin dy-tre shpulla dhe e dorëzonin te policët!

Thirrja "hajduti", akoma pa u dëgjuar mirë i bënte njerëzit të vraponin drejt zërit për ta ndihmuar...

Ndërsa tani, gjendja ka ndryshuar. Hajdutët sulmojnë autobus të mbushur me njerëz, burra e gra. Njëri ua merr sendet e çmuara e tjetri u rri me armë mbi kokë! Njerëzit heshtin e sytë u treten derisa krimi të marrë fund e hajdutët të fshihen në stacionin më të afërt!

Çfarë do të ndodhte nëse dikush do të kundërshtonte? Të ngriheshin njerëzit shpirtmëdhenj e të bënin rezistencë edhe në qoftë se do pësonin ndonjë të keqe? Ata, patjetër që do të triumfonin, sepse nuk mundet që dy veta të mposhtin njëzet, apo tridhjetë pasagjerë, por "kriza e shpirtmadhësisë" mbizotëron dhe hajdutët marrin forcë e sherri i tyre ndizet!

Sikur ta kishin hedhur hajdutin nga autobusi e gjaku i tij të derdhej, askush nuk do të kishte ndjerë keqardhje për të, por njerëzit nga frika e poshtërimin, jetojnë në poshtërim...!!

Është kjo "kriza e shpirtmadhësisë" që e lejon hajdutin të vjedhë një motor, të grabisë zinxhirin e një vajze, apo byzlykun nga dora e saj dhe të ecë rrugës i pa shqetësuar për asgjë!!

KRIZA E SHPIRTMADHËSISË

Sikur njerëzit në rrugë të ishin zgjuar do ta ndiqnin duke thirrur për ta ndaluar, ta zbrisnin prej motorit, e t'ia kthenin gjënë e vjedhur të zotit dhe hajdutin ta dorëzonin në polici.

Nuk e di, a thua njerëzit janë në gjendje shoku dhe kanë humbur ndjesinë për atë që ndodh rreth tyre, apo ata kanë ndjesi, por çështja nuk u intereson dhe nuk ua zgjon vëmendjen??

Prej mësimeve të para të Islamit është se **"myslimani është vëlla i myslimanit, nuk i bën padrejtësi, nuk e zhgënjën dhe nuk e poshtëron"**. Transmeton Ebu Davudi nga Xhabir dhe Ebu Talha (r.hm) se Pejgamberi (a.s) ka thënë: **"Nuk ka mysliman që zhgënjën (lë në baltë) një njeri mysliman në një vend që është duke u çnderuar dhe duke u përdhosur, përveç se Allahu do ta zhgënjë atë (do ta lë pa ndihmë) në një situatë që dëshiron të ndihmohet. Dhe, nuk ka mysliman që ndihmon një mysliman në një vend që është duke u çnderuar dhe duke u përdhosur, përveç se Allahu do ta ndihmojë në një situatë që dëshiron të ndihmohet"**.

Transmetohet përsëri: **"Pasha Madhërinë dhe Madhështinë Time,**



patjetër do të hakmerrem ndaj zullumqarit, shpejt ose vonë dhe patjetër do të hakmerrem ndaj atij që shikon një të keqtrajtuar, ka fuqi ta ndihmojë dhe nuk vepron".

Përse nuk vepron?

Moskokëçarje ndaj kimit! Mungesë keqardhje për të poshtëruarin! Mungesë ndjesie për vëllazërimin e përbashkët!

Situatat përsëritet, jeta vazhdon e një ditë do të ndihesh i braktisur dhe do të kërkosh për dikë që të ndihmojë e nuk do ta gjesh, sepse ti kështu ke vepruar më parë me dikë tjetër!

Dikur njerëzit nuk e kursenin neveritjen për një krim që ndodhte. Kujtoj një herë e një kohë kur isha student dhe po udhëtoja nga Turami për në shkollë. Pashë një djalë që qëllloi një tjetër, i cili ishte ulur pranë meje. E shikova në mënyrë akuzuese dhe ai me të shpejtë ma ktheu: Ai po ngacmonte vajzën që është ulur në karrigen tjetër. Heshta dhe bashkë me mua heshtën edhe pasagjerët e tjerë duke e miratuar për veprimin që bëri!!

Kur një zonjë hynte në autobus të mbushur plot me njerëz, burrat menjëherë ngriheshin në këmbë për t'i liruar vendin, në shenjë respekti për femrën dhe nderin e saj.

Ndërsa tani, dëgjojmë për histori përdhunimi të ulëta, mashtrim të vajzave të dobëta dhe shfrytëzim poshtëruar i vështirësive të saj për ta shtjerë në dorë.

Kriza e shpirtmadhësisë është argument i rënies së shpirtit fetar dhe burrëror dhe përhapjes së çmendurisë shtazarake pa asnjë shqetësim. Çështja ka nevojë për mjekim të shpejtë, sepse ulja këmbëkryq e së keqes deri në këtë pikë është alarm i degradimit, humbjes dhe vazhdimësisë së disfatave poshtëruese.

Përktheu nga arabishtja:

Lavdrim Hamja



Naim Drijaj - imam, xhamia Parrucë

Për nga rëndësia, dashuria për Pejgamberin (a.s) vjen menjëherë pas dashurisë që besimtari duhet të ushqejë ndaj Allahut xh.sh., madje mund të themi se dashuria ndaj Pejgamberit (a.s) buron nga dashuria jonë për Allahun. Ai që e do Allahun, padyshim, e do edhe Pejgamberin (a.s), sepse Allahu xh.sh. e ka bashkuar emrin e Vet hyjnor me emrin e Tij: “La ilahe ilallah Muhamedur-resulullah”.

Nuk mjafton të thuhet vetëm me gojë se unë e dua Pejgamberin a.s, por. Pas këtij pohimi kërkohet edhe shkuarja pas mësimeve të tij dhe praktikimi i tyre. Allahu xh.sh. thotë: “Thuaj! Nëse e doni Allahun, atëherë ejani pas meje që Allahu t’ju dojë, t’ju falë gjynahet tuaja. Allahu falë dhe mëshiron shumë”. (Ali Imran, 31)

Sehl ibën Abdullah ka thënë: “Shenjë e dashurisë së Allahut është të duash Kuranin. Shenjë e dashurisë së Kuranit është të duash pejgamberin. Shenjë

DASHURIA NDAJ PEJGAMBERIT (A.S)

e dashurisë së Pejgamberit është të duash sunetin e tij.

Enes ibn Maliku r.a. tregon se një njeri e ka pyetur Pejgamberin (a.s) se kur do të ndodhë Dita e gjykimit. Pejgamberi (a.s) e pyeti se çfarë kishite përgatitur ai për Ditën e gjykimit. Personi iu përgjigj: Për Ditën e gjykimit nuk kam përgatitur shumë gjëra me përjashtim të obligimeve, por e dua Allahun dhe Pejgamberin e Tij. Pejgamberi (a.s) i tha: Ti do të jesh në botën tjetër sëbashku me atë që e do. (Buhari)

Dashuria është baza e çdo veprë në këtë jetë. Çdo vepër në botë buron nga dashuria dhe dëshira. - (Kaide fil mehabbe, Ibën Tejmijje 2/193 dhe 202)

Në një hadith të transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Asnjëri nuk ka besuar plotësisht përderisa të mos më dojë mua më shumë se baban, fëmijët e tij, veten dhe njerëzit mbarë”.

Në lufën e Uhudit një gruajë muslimane nga fisi Beni Dinar, i vdiqën në luftë burri, vëllai dhe i ati. Kur e lajmëruan dhe u përpoqën që ta ngushëllonin, ajo u tha njerëzve që e rrethonin: çfarë i ka ndodhur Pejgamberit (a.s)? I thanë: Ai është gjallë. Tha: Ma tregoni që ta shoh. Kur e pa se ai ishte i gjallë tha: çdo fatkeqësi është e parëndësi-

shme përpara fatkeqsisë së humbjes tënde”. - (Siretu Ibn Is’hak, 2, 99).

Omer ibën Hattabi r.a. një herë i tha Pejgamberit (a.s) : “O i Dërguar i Allahut, vërtet unë të dua më shumë se çdo gjë, përveç vetes time! Pejgamberi (a.s) tha: Jo, pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, ti nuk më don mua me të vërtetë nëqoftëse e don veten tënde më shumë se mua. Omeri r.a. tha: Pas këtij çasti, pasha Allahun, ti je më i dashur për mua se vetja ime. Pejgamberi (a.s) tha: Tani po, o Omer.” (Buhariu)

Dashuria ndaj Pejgamberit (a.s) bën të mundur që besimtari të shijojë ëmbëlsinë e (imanit) besimit. **Buhariu dhe Muslimi** transmetojnë nga Enesi r.a. se Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kush i zotëron tri gjëra ai do ta shijojë ëmbëlsinë e besimit: njëra prej tyre është ta duash Allahun dhe të dërguarin e Tij me shumë se çdo gjë tjetër”.

Hubejb ibni Adijjin, e zënë rob pas kurthit që i ngritën muslimanëve disa fise politeist, mushrikët e pyetën pak përpara momentit të ekzekutimit: A do të dëshiroje që në këtë çast, në vendin tënd të ishte Muhammedi (a.s)? Dhe përgjigjja e tij ishte e prerë dhe e qartë: Jo, Vallahi nuk do të pranoja që, në këmbim të shpëtimit tim, atij t’i ngulej qoftë edhe një gjemb në këmbë. Pastaj



mushrikët, armiqtë e Allahut dhe të pejgamberit, vendosën ta ekzekutojnë. Hubejb ibni Adijj r.a i ngrit duart nga qielli e tha: O Allah nuk mund ta përshëndes për të fundit herë, të dashurin Tënd (a.s), prandaj dërgoja Ti përshëndetjen time atje ku ndodhet. Muhammedi (a.s) gjendej me shokët e tij kur ata dëgjuan se ai tha: Të përshëndes edhe unë ty o Hubejb. Të habitur ashabët e pyetën të dërguarin e Allahut se ç'kishte? Ai me lot në sy u tha: Hubejbi ra shehid, por në çastin e fundit të jetës nuk harroi të më dërgonte selame. Allahumme sal-li ala Muhammedin ue ala ali Muhammed.

CILAT JANË SHENJAT SE E DUAM PEJGAMBERIN (A.S)?

1. Pasimi i tij.
2. Përmendja e tij.

Transmetohet nga Abdurrahman Bin Auvfi se ka thënë: “Shkova njëherë tek Pejgamberi, (a.s) dhe e gjeta në sexhde ku qëndroi shumë gjatë. Pastaj tha: “Më erdhi Xhibrili dhe më tha: Kush përcjellë salavate mbi ty, unë do t'i përcjellë salavate atij. Kush përcjellë selame mbi ty, unë do t'i përcjellë selame atij. Për këtë arsye qëndrova në sexhde për ta falënderuar Allahun.” - (Transmeton Hakimi dhe Ahmed. Albani thotë se hadith është sahih)

3. Të vepruarit sipas sunnetit të Tij

4. Njohja e jetës së pejgamberit (a.s)

Është e vërtet se njeriu e do më shumë atë që e njeh se sa atë që nuk e njeh. Njeriu më shumë pikëllohet në

rast fatkeqësie për atë që e njeh se sa për atë që nuk e njeh. Njohja e jetës së pejgamberit (a.s) është obligim sepse atë e kemi obligim ta marrim për model e nuk ke mundësi ta marrësh dikë për model shembull duke mos e njohur.

Ebu Bekri r.a ishte ai që e shoqëroi pejgamberin (a.s) për në Medinë gjatë hixhretit. Deri sa strehoheshin në shpellën Theur, pejgamberi (a.s) kishte vendosur kokën e tij a.s të ndëruar në prehrin e pastër të Ebu Bekrit r.a për të pushuar. Pas një kohe pejgamberit (a.s) i ranë ca pika lot në fytyrën e ti. Ai u zgjua dhe tha: “ç'është kjo o Ebu Beker? Asgjë, asgjë o pejgamber i Allahut vetëm pusho. Pasi pushoi pejgamberi (a.s) u zgjua prapë e pyeti Ebu Bekrin se ç'kishin ata lot që më ranë në fytyrë? Ebu Bekri iu përgjigj: lotët më pikuan ngase një gjarpër më kafshoi në këmbë. E pse s'u largove nga ai e pyeti pejgamberi (a.s) Jo, jo nuk desha të shqetësoi ty o i dërguar i Allahut. Atëherë pejgamberi a.s bëri lutje për të dhe o fërkoj këmbën Ebu Bekrit me çka menjëherë iu ndal dhimbja.

Omer ibn Hattabi r.a. i ka thënë Abbasit, axhës së Pejgamberit (a.s): bëhu musliman, sepse vall-llahi, më e dashur te unë është të bëhesh musliman ti sesa Hatabi. Jo për ndonjë gjë tjetër përveç se ishte më i dashur te Pejgamberi (a.s)” - (Tefsir Ibn Kethir, 2/ 326-327).

Amr ibnul-Asi pasi pranoi Islamit tha se asnjë njeri më parë nuk kishte urrejtur më shumë se Muhammedin

(a.s) por kur ai pranoi Islamit nuk kishte njeri mbi fytyrë tokës që e donte dhe e rrespektonte më shumë se ate. Ai tha: “Sikur ju të më pyetni mua t'ua përshkruaj Pejgamberin a.s, nuk do të kisha mundësi, sepse unë nuk pata mundësi asnjëherë t'i mbush sytë e mi nga drita e tij”.

Urvetu ibnu Mes'udi u tha kurejshitetëve: “O ju popull! Mua më dërguan te Kisraja (mbreti i persëve) dhe tek Kajseri (mbreti i romakëve), por nuk e pashë njeri të cilin e respektojnë shokët e tij sikurse e respektojnë shokët e Muhammedit-Muhammedin (a.s)

Transmeton Nesaiu, Ibn Hibani dhe Buhariu ne librin e tij “Terihul-kebir” se Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Shejtani është përpjekur ta pengojë birin e Ademit në tri gjëra. Është përpjekur ta pengojë në fe dhe i ka thënë: ‘Për çfarë po e lë fenë tënde dhe fenë e baballarëve të tu?’ Biri i Ademit e kundërshtoi shejtanin dhe e pranoi Islamit. Pastaj është përpjekur ta ndalojë prej hixhretit për hir të Allahut duke i thënë: ‘A po e lë pasurinë tënde, familjen tënde dhe po bën hixhret?’ Biri i Ademit e kundërshtoi shejtanin dhe bëri hixhret. Pastaj u përpoq që ta pendojë nga lufta në rrugën e Allahut duke i thënë: ‘Po lufton që të vritesh, pastaj familja jote do të martohen dhe pasuria do të ndahet.’ E kundërshtoi biri i Ademit shejtanin dhe luftoi, derisa e meritoi xhenetin e Allahut”.

E lusim Allahun xh.sh. që edhe ne të edukohemi me dashurinë që kishin sahabët për Pejgamberin (a.s).





MBRËMJA “VLERA TË VËLLA

Ditën e mërkurë, më 2 prill 2014, Myftinia Shkodër ka ftuar besimtarë të marrin pjesë në aktivitetin fetar me temë: “Vlera të vëllazërisë islame”, në kuadër të nismës së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë: “Frytet e besimit”.

Aktiviteti ka nisur me këndimin e ezanit të akshamit nga teologu Bilal Teqja, i cili ka drejtuar edhe namazin e akshamit, duke mbushur zemrat e besimtarëve me leximin e bukur të Kur’anit.

Më pas, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, ka vlerësuar se këto mbrëmje fetare janë një mundësi më shumë për t’u afruar me dashninë e All-llahut, në rrugën e dëshmimit si besimtarë të përkushtuar që e duan dhe e mbrojnë njëri-tjetrin.

Myftiu ka uruar mirëseardhjen në Shkodër të dy nënkryetarëve të KMSH, z. Gazmend Aga dhe z. Klodi Shehu, të kancelarit të KMSH, z. Ali Zaimi, drejtorit të Thirrjes Islame në KMSH, z. Elvis Naçi, Myftiut të Ma-

A FETARE: "AZËRISË ISLAME"

lësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj etj.

Në ligjëratat e mabjtura para të pranishëmve, z. Ali Zaimi dhe teologu Elvis Naçi, kanë hedhur dritë mbi vlerat e vëllazërisë islame dhe domosdoshmërinë e angazhimit të secilit për të dëshmuar sa më mirë këto vlera islame. Është vënë theksi te ajetet kur'anore dhe hadithet e ndryshme, që nxisin muslimanët për të lënë mënjanë veset dhe ndikuesit që e dobësojnë vëllazërinë islame, si dhe të punojnë me përkushtim në rrugën e forcimit të saj në shoqëri.

Me shumë emocion janë përcjellur edhe ilahitë e bukura, me tekste të vjetra shqipe, të kënduara me shumë mjeshtri nga H. Sami Muçej, 83 vjeçari që vazhdon të shërbejë me shumë përkushtim në gjallërimin e xhamive me këndimet e bukura të pjesëve të "Mevludit" dhe ilahive të larmishme.

Pas faljes së namazit të jacisë me xhemat, për të pranishmit është shpërndarë edhe ujë Zemzemi.



Promovohet libri: “E vërteta e hidhur”, nga dijetari Shejkh Muhammed El-Gazali



Pasditën e së xhumasë, më 11 prill 2014, në një atmosferë të këndshme besimi dhe vëllazërie islame, është promovuar përkthimi në shqip i librit të dijetarit Shejkh Muhammed El-Gazali, “E vërteta e hidhur”, realizuar nga thirrësi islam, Lavdrim Hamja.

Në krye të herës, teologu Ervil Kuçi, ka bërë një prezantim të shpejtë të librit, duke vënë theksin te rëndësia e promovimit të botimeve të reja islame në gjuhën shqipe. Gjatë fjalës së tij, ai ka spikatur një pjesë nga libri, rreth “sëmundjeve të zemrës”.

Një recensë të librit e ka bërë teologu Arben Halluni, gjatë fjalës së të cilit, është prezantuar thelbi i këtij libri, që është konsideruar si recetë për shumë nga problematikat me të cilat përballet ymeti islam, individi dhe shoqëria.

Me shumë vëmendje është ndjekur fjala e përkthyesit, z. Lavdrim Hamja. Në fjalën e tij, teologu Hamja ka vlerësuar mendimin dhe shpirtin me të cilin Shejkh Muhammed El-Gazali ka shkruar veprat e tij, të cilat janë përhapur në botën islame, duke u vlerësuar maksimalisht nga lexuesit e ndryshëm të tyre.

Gjatë fjalës së tij, është ndalur tek përkufizimi që i bën autori demokracisë dhe si trajtohen muslimanët në raport me demokracinë në botë.

Aktivitetin e ka përshëndetur edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, që pasi ka falënderuar përkthyesin Lavdrim Hamja për kontributin e tij në shqipërimin e veprave të ndryshme të Shejkh Gazaliut, është ndalur në leximin e pjesës me titull: “Njerëz pa dinjitet”, në të cilën, autori përkufizon njerëzit me pushtet që shesin dinjitetin e tyre duke sulmuar Islamin, ndërkohë, jashtë vendeve të tyre, i binden verbërisht rregullave dhe besimeve të tjetrit.

Me këtë rast, Myftiu i ka dhuruar përkthyesit Lavdrim Hamja, një kujtim nga shënimet vetanake të hoxhallarëve të nderuar shkodranë, H. Jusuf Këlmendi (1876-1943), H. Ali Kraja (1900-1973) dhe H. Esat Myftija (1911-1975), të mbledhura në një faqe libri të vjetër në arabisht.

Aktivitetin e ka përshëndetur edhe Myftiu i Malësissë së Madhe, H. Edmir Smajlaj dhe imami i xhamisë së Rusit, H. Fejzi Zaganjori, që kanë falënderuar përkthyesin për këtë kontribut, si dhe Myftininë Shkodër për mbështetjen e botimit.



A E KENI DITUR SE

HAFIZI I KUR'ANIT,

IMAMI SHKODRAN,

SHEH ALI KRUJA

(1884-1976),

TEKSA LUFTONTE

NË MBROJTJE

TË ATDHEUT,

NË KOPLIK, 1920,

KUNDËR

SERBO-MALAZEZËVE,

HUMBI SYRIN E MAJTË.



Lavdrim Hamja, teolog

Libri "E vërteta e hidhur" e dijetarit Shejkh Muhammed El-Gazali përmban artikuj me vlerë, shkruar nga autori gjatë një periudhe kohore relativisht të gjatë. Përmes këtyre shkrimeve autori i bën një mbrojtje Islamit nga dy grupe njerëzish të ndryshëm. Njëri grup janë myslimanët me dije të cekët, të cilët e njollosin Islamit me diçka që ai nuk e ka, ndërsa grupi tjetër janë armiq të Islamit, që përpiqen ta akuzojnë fenë tonë me gjëra, që nuk i përkasin dhe as nuk kanë lidhje me të.

Në fakt, libri që kemi në duar, "E vërteta e hidhur", në gjuhën arabe ka gjashtë vëllime. Në këtë përkthim në shqip kam sjellë vetëm disa tema nga tre vëllimet e para, të cilat kam menduar se janë më të dobishme dhe më të përshtatshme me realitetin shqiptar. Lexuesi i këtyre rreshtave gjatë leximit do të vërë re vërtetësinë dhe sinjeritetin e autorit në ato çfarë ka shkruar, që edhe pse datojnë vite më parë, janë akoma aktuale, pasi autori sjell realen, të cilën e ka mësuar nga praktika e fjalës së Allahut (xh.sh) dhe Sunetit të Dërguarit të Tij (a.s).

E veçanta e këtij libri është se autori mbështetet në shkrimin e artikujve të shkurtër dhe thotë: "Në këtë rrugë kam pasuar Ibn Xhevziun, sepse libri i tij "Sajdul Khatir" përmban shkrime të shkurtra, por ato janë shumë të dobishme, madje ndoshta janë më të mira se sa temat e gjata... Lexuesi i sotëm zakonisht mjaftohet me pëlqimin e artikujve të shkurtër ndaj atyre

PSE DUHET LEXUAR "E VËRTETA E HIDHUR" E SHEJKH GAZALIUT?

të gjatë dhe shumë të gjatë. Kryesorja është që ta shfrytëzojmë këtë dëshirë, për të vendosur te lexuesi në mënyrë të shpejtë fakte nxitëse dhe udhëzime serioze".

Ai vazhdon duke thënë: "Këto janë fjalë të shkurtra, por janë çelësa të shkëndijave të shumta të njerëzisë xhelozë për fenë dhe ymetin e tyre".

Shejkh Gazali nuk e shpjegon arsyen se pse e ka quajtur librin "E vërteta e hidhur", por lexuesi gjatë leximit e kupton se titulli është në përputhje të plotë me realitetin e ymetit islam në mbarë botën. Me fjalë të tjera libri evidenton dhe ana-



lizon gjendjen e ymetit e të myslimanëve dhe jep alternativën islame të zgjidhjes së problemeve. Mund të përmendja këtu disa prej këtyre temave, si: "Rreziku i ndryshimeve dytësore", "Vendi i gruas në Islam", "Hadithi i dobët", "Përçarja", "Guximi i atyre që sulmojnë selefët", "Përse e urrejnë shtetin islam", "Një vështrim i zgjuar rreth haditheve të trazirave" etj.

P.sh, te shkrimi me titull: "Rreziku i ndryshimeve dytësore" thotë: "Mua më përfytyrohet sikur këto ndryshime dytësore përngjasojnë me format e bakteve, të cilat na tregohen nëpër librat e mjekësisë dhe poshtë tyre shënohet: "mikrob", filan sëmundje e zmadhuar 1000 herë!! Zmadhimi i këtyre formave për t'i njohur është i kuptueshëm, por çfarë kuptimi ka zmadhimi i këtyre ndryshimeve në mesin e mendimeve dhe opinionëve të disa dijetarëve, deri sa ato të duken sikur janë të vërteta të popujve të zhdukur? Rezultatet e tyre (pra, zmadhimi i këtyre ndryshimeve) kanë qenë bela për shoqërinë tonë fetare, sepse ky hiperbolizim i fabrikuar mbuloi fusha të gjera, të cilat duhej të lëvizeshin prej moralit që asnjë popull nuk ngrihej, përveçse me to".

Te tema: "Një vështrim i zgjuar rreth haditheve të trazirave", Shejkh Gazali thotë: "Ekzekutimi nuk i zgjidh problemet e brendshme dhe ndërprerja e lidhjeve farefisnore rritet duke marr hak dhe garantohet duke falë. Kur gjërat ndërlikohen për motive politike, atëherë çelësi i tyre është zgjidhja politike dhe jo derdhja e gjakut të njerëzve... Kur babai shikon se ngatërresa me vëllezërve ka çuar në humbjen e jetës së njerit prej tyre, atëherë ai nuk thërret për ekzekutim e tjetrit që të marrë hak, sepse kjo gjë përfundon me humbjen e krejt familjes. Ai do të përpiqet t'i qetësojë gjërat, pastaj fillon të shikojë ndreqjen e asaj që ka ngjarë".

Ndërsa, ajo që më ka bërë më shumë përshtypje ka qenë tema "Përse e urrejnë shtetin islam", ku Shejkh Gazali e mposht debatuesin duke i thënë: "E pyeta: Cili është përkufizimi i demokracisë? M'u përgjigj: Sundimi i popullit për popullin, pra populli është burimi i udhëheqjes! I thashë:

“Kur shikon kasapin duke dhënë fetva, mos prit asgjë tjetër prej tij, vetëm se duke kërkuar për ndonjë kurban!”

Përveç, në qoftë se populli është mysliman... sepse po qe se populli është mysliman, atëherë duhet që ai të mos sundojë vetë për veten e tij dhe të mos jetë ai burimi i udhëheqjes që rregullon çështjet e tij, por atë duhet ta sundojë dikush tjetër me ligje dhe parime të importuara! ... Dashuria e myslimanëve për Akiden, besimin dhe Sheriatin e tyre nuk ndërpritet asnjëherë, por ju e pushoni këtë dëshirë me mënyra dhe forma që s'kanë të numëruar: Falsifikim votimesh, falsifikim mediatik, falsifikim artikujsh, falsifikim fetvash dhe kur të gjitha këto falsifikime nuk bëjnë dobi, atëherë i vjen radha shpatës (dhunës) duke i mbyllur gojët dhe duke i spastruar njerëzit...”!

Tematika e librit është e larmishme dhe nuk cekë vetëm një fushë të veçantë prej dijes së Islamit, "nganjëherë trajtojnë tema të besimit, të moralit, të historisë dhe të fikhut (jurisprudencës) dhe nganjëherë zhyten në realitetin tonë të gjallë për t'i vënë në lëvizje punëtorët e rrugës së Allahut për të vendosur të drejtën dhe për të shkatërruar të shtrembrën".

Interesante është edhe pjesa e fundit, të cilën e kam shtuar vetë dhe përmban disa thënie të goditura të Shejkh Muhamed El-Gazaliut, ku po mjaftohem me citimin e disa prej tyre:

“Myslimani, kur i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nuk struket brenda kullës me mure të rrethuara duke lundruar përmes iluzioneve të forta. Kulla e myslimanit është kjo Tokë, sa gjerë e gjatë, duke e mbushur atë me punë precize dhe detyra të kërkuara. Nuk quhet precizon rregullimi i një pjese të detyrave dhe lënia pas dore e pjesëve të tjera, që ndoshta mund të jenë më të rëndësishme dhe më të larta. Por, rregullim quhet kryerja e farzeve ajne dhe kifaje, detyrave individuale dhe kolektive dhe trajtimi i punëve të dynjasë dhe të ahiretit së bashku”.

“Kur shikon kasapin duke dhënë fetva, mos prit asgjë tjetër prej tij, vetëm se duke kërkuar për ndonjë kurban!”

“Detyra e fesë është që kur të shikojë një të rrëzuar ta ndihmojë për tu ngritur dhe jo të nxitojë për ta diskredituar”.

“Myslimani, në ndërgjegjen e të cilit nuk jeton Pejgamberi a.s, ku zemra dhe mendja nuk e pasojnë atë në çdo vepër të tij, nuk i bën aspak dobi të lëvizë buzët ditë natë, as edhe me një mijë salavate”.

“N.q.s feja nuk rrjedh në shpirtrat e njerëzve, ashtu siç rrjedh rryma elektrike nëpër tela, duke ndriçuar e duke vënë në lëvizje makineri, atëherë ajo kthehet në iluzione dhe pretendime për të cilat nuk kanë dobi simbolet e as parullat”.

Në fund, ashtu si ka thënë edhe Pejgamberi (a.s) "Kush nuk falënderon njerëzit, nuk ka falënderuar Zotin", me lejoni të falënderoj të gjithë ata, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre, në çfarëdolloj mënyre për librin në shqip "E vërteta e hidhur", falënderoj familjen, sponsorizuesit, redaktorin, Shtëpinë Botuese dhe sigurisht Myftinë Shkodër dhe Myftiun, Imam Muhamed Sytari, për mbështetjen që ka dhënë dhe vazhdon të japë për botimet islame, por jo vetëm.

Të gjithëve, Allahu jua shpërbleftë me të mira dhe ju dhashtë mbarësi në jetën tuaj.



"O BIR,
FITO
ALL-LLAHUN,
KE FITUAR
ÇDO GJË!"
SHEJKH AHMED KEFTARO.



**Mirë se vini në kopshtin:
“Aromë Trëndafili”!**

**Regjistrimet kanë filluar.
Ju mund të paraqiteni
çdo ditë pranë Qendrës “Daut Boriçi”, Perash.**

**Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe i kontrolluar,
staf i kualifikuar, çmime të arsyeshme,
transporti është i garantuar.**

Na kontaktoni në numrin 0676078223.

Ju mirëpresim!

(Me mbështetjen e Shoqatës “Istanbul”)

KONFERENCA III E IMAMËVE TË SHKODRËS



Ditën e xhuma, më 28 mars 2014, është zhvilluar Konferenca e tretë vjetore e imamëve të Myftinisë Shkodër.

Në qendër të fjalës së Myftiut, Imam Muhamed Sytari, kanë qenë sfidat me të cilat përballet bashkësia e muslimanëve në Shkodër dhe në Shqipëri, si dhe angazhimi serioz dhe maksimal i secilit në rrugëtimet shërbyese ndaj Fjalës së Zotit dhe mësimëve të Tij.

Në fjalën e mbajtur para të pranishëmve, Myftiu i Shkodrës, ka tërhequr vëmendjen e imamëve që të jenë korrektë me detyrën që kanë marrë mbi supe dhe të mos ndikohen nga asnjë tendencë a thirrje shterpë për ta nënçmuar rolin që imami ka në shoqëri.

Myftiu ka dënuar thirrjet mesjetare të disa "mjeranëve, që edhe nëpërmjet gazetës "Panorama", duan të

bëhen protagonist, duke derdhur vnerin gjenetik kundër Islamit dhe muslimanëve..." dhe, atë që e ka quajtur: "kryqëzatë të dëshpëruar të disave që duan të na kthejnë në mentalitetet meskine të disa gazetave të këtij shpirti, që dilnin në Shkodrën e dhjetë viteve të fundit, duke mbjellur dasi fetare, urrejtje dhe mllëfe mjerane"

Gjithashtu, Myftiu ka kërkuar që Islami mos të izolohet vetëm në katër muret e xhamive, por të punohet për përhapjen e tij edhe përtej xhamive. "Në këtë kontekst, kur përmendim shërbimet tona ndaj vlerave kombëtare, duhet të keni parasysh se traditat më të mira shqiptare e kanë origjinën e tyre në Kur'an dhe në traditën e Hz. Muhamedit (a.s)" - ka theksuar në fjalën e tij Imam Muhamed Sytari.

Me shumë interes është ndjekur

edhe fjala e imamit të xhamisë së Rusit, H. Fejzi Zaganjori, në të cilën është ndalur edhe në një detaj shumë interesant, kur ka theksuar: "Historinë le t'ia lëmë historianëve, por kur vjen fjala për Islamit dhe dëgjohet se ai ishte prurje e pushtuesit, atëherë edhe katolicizmin e sollën pushtuesit romakë, ortodoksinë pushtues sllavë!? Por, ky mentalitet, nuk ka lidhje me shpirtin me të cilin duhet të ecë përpara kombi shqiptar dhe komunitetet fetare në të!".

Gjatë kësaj konference, janë dhënë udhëzime të shumta në drejtim të përmirësimit dhe rritjes së cilësisë së prezantimit të vlerave islame, si dhe është kërkuar nga imamët që të jenë në krye të detyrës, duke u bërë mësues të urtë, jo nxënës të mendimeve dhe ideve që futen në trupin e bashkësisë tonë për ta shkatërruar e për ta prishur harmoninë në mesin e muslimanëve.



Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

KOHA PËR TË MOS U BËRË PALË ME HESHTJEN..!

(reflektim në krahët e një sprove komunitare)

Andreqet ky realitet, në të cilin ne, muslimanët shqiptarë, vihemi sërish në qendër të vëmendjes sociale, teksa rishfaqen në horizont shenjat e para të një stine të “gjuetisë së shtrigave”, stolisur me një terminologji dhe një mori etiketimesh absurde, ndaj të cilave feja islame ka qëndrime refuzuese dhe kritikuese, jo më të jenë pjesë e doktrinës së saj fetare!?

A ka kuptim të përfshihemi në një vorbull paradoksale, e cila nuk bën asgjë tjetër, vetëm se thith në thellësitë e errësirës së saj individë a grup-njerëzish, duke u munduar t’u ndryshojë pamje, ngjyrë, moral e vokacion shpirtëror, në kuadër të një “ere të re” në rrugëtimet historike të vendit tonë?

Por, a ka përgjegjës për këtë realitet, sa qesharak aq edhe të trishtë, të muslimanëve në këtë vend, si dhe me mënyrat e trajtimit të fesë islame në këto 24 vjet, që nga dita e rilejimit me ligj të besimeve fetare, (pas një kataklizme kombëtare 23 vjeçare, ku politika dhe afetarizmi, ngërthyen me kthetrat e tyre një shtet të tërë, duke e dëshmuar si një palaço në sytë e botës, teksa dëshmonte me mburrje primitive, se: “Ne jemi shteti i vetëm ateist në botë”)?!

A ka fajtor, për shkeljen flagrante të ligjeve, ndaj të drejtave të vazhueshme me shami, paragjykimet të praktikanëve të fesë, (ri)grabitjes së pronave të shenjta vakëf, nëpërmjet ligjit të legalizimit, moskompensimit serioz të pronave vakëf, të sekuestruara e të tjetërsuara nga shteti komunist? A ka përgjegjës për mbjelljen në heshtje të dasive sektare nëpërmjet etiketimit të klasës së teologëve të diplomuar në shkollat më të mira të botës islame, si: arabë e turqë, me mjekra dhe pa mjekra dhe, papjekurinë e tyre për ta kapërcyer këtë ngërç të futur në mes tyre, si një vi-

rus shkatërrimtar?

A ka fajtor, që gjatë gjithë kësaj kohe, klasa politike me krejt ngjyrat e saj, ka luajtur pandershmërisht me të drejtën legjitime të muslimanëve kryeqytetas për të pasur xhaminë e tyre katedrale, njësoj si vëllezërit e tyre të krishterë; katolikë e ortodoksë (që të paktën, falë Zotit, janë favorizuar dukshëm nga qeveritë e ndryshme të dy dekadave të fundit)?

A ka fajtor, që akoma sot, një tendencë mbytëse tenton të shuajë zërin e vetëdijes islame në këtë vend, edhe nëpërmjet përpjekjeve për ta izoluar nga realitetet, a për t’i dhënë institucionit të muslimanëve një ngjyrë që nuk është e tij dhe që kurrë nuk mund ta ketë; izolimin dhe daljen nga skenat e realiteteve dhe

**Është koha
për të dëshmuar
bashkërisht vullnetin
për t’i shërbyer
një kauze të shenjtë
e të shtrenjtë:
ruajtjes së vlerave
të besimit dhe të fesë,
në harmoni të plotë me
trashëgiminë kombëtare
dhe aspiratës për një
të ardhme, të çliruar nga
mentaliteti i përjashtimit
të tjetrit dhe izolimit
nga kushdo ndryshe!**

kontributeve të vyera kombëtare, që prodhojnë thellim të hendekut në rolin që duhet të ketë institucioni dhe njerëzit e tij të ditur e të specializuar?!

Çfarë kuptimi ka, që sot, dikush të na thotë: “ata duhet të na japin prova se e dinë mirë që ky komb është dhe i të tjerëve, të krishterë, laikë a ateistë qofshin, duhet të na japin prova se këtë vend e këtë komb e duan po aq sa ne të tjerët, duhet të na japin prova se interesi kombëtar është një gjë që nuk mund të negociohet”. Ne të japim prova për këtë vend dhe interesat e tij? Ne muslimanët, që ndër shekuj e kemi ujitur këtë tokë me paqe, me pastërti, me harmoni ndaj jomuslimanëve, me një shembull të mrekullueshëm të bashkëjetesës paqësore në rrafshin popullor!?

E vërteta është se ky shpirt e ky udhëzim, që nuk ndryshon për asgjë ndër ne, shpesh është prekur nga duar të papastra (jashtë nesh), që tinëz kanë luajtur me harbuti kartën e “tolerancës dhe harmonisë fetare”, duke abuzuar me simbole fetare, me të cilat kanë mbushur sheshe e rrugë, në shenjë servilizmi ndaj dikujt, që sheh nga jashtë!?

Në fakt, kjo pyetje: “A ka fajtor..?”, mund të vazhdonte deri në pafundësi, duke iu referuar ndodhive të çuditshme dhe realiteteve plot kotësi mendimi dhe arsytimi, me të cilat trajtohet Islami dhe muslimanët në këtë vend! Por, fajtori/ët, nuk është e lehtë të etiketohet/en!? E, mbi të gjitha, nuk do të duhet shumë kohë për t’u humbur, në rrugën e kthimit të fletëve, në drejtim të shërimit dhe tejkalimit të pragut të sprovës..!

Përgjegjës, fillimisht, (jo për te-

ndencë paragjykimi e akuze, sesa për konstatim para një analize të qetë e të vëmendshme), është Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, (si institucion, që ka kaluar dallgë e lëkundje të frikshme) në rrugëtimin e tij të çalët 23 vjeçar (ku të gjithë kemi nga pak hise, në këtë mungesë ekuilibri)!

Janë teologët dhe thirrësit islamë, shpesh të pavëmendshëm (edhe për faktorë jashtë tyre) ndaj zhvillimeve gjarpëruese të vendit, sfidave të kohës dhe mbi të gjitha realiteteve të vetë institucionit të tyre, që ka rënkuar për t'i pasur të gjithë së bashku, rreth një sofere të shenjtë, mbi krejt sofrat lokale e tendencat sektarizuese të tipit: "Mendimi im është i drejtë, por pranon edhe gabimin. Mendimi yt është i gabuar, por pranon edhe të drejtën"!?

Janë intelektualët muslimanë dhe njerëzit vullnetmirë të këtij vendi, që kanë heshtur a janë kënaqur me "shfryrjet" momentale në medime a takime spontane (a edhe të organizuara, pa sukses), a duke turfulluar, gjatë leximit të analizave të karikuarra me mllef, (të ardhura edhe nga jashtë kufijve, në gjuhën shqipe)!?

Janë krejt muslimanët e mirë shqiptarë, që e kanë lënë veten të trajtohen si pakicë e shkelur (sidomos në provinca të sunduara nga politika moniste, nën vellon e demokracisë), a që kanë pranuar neglizhencën si vulë kohe, duke u dëshmuar si një tërësi e pavlerë mendimi, shpirti e kulture..!

Por, asnjëherë nuk është vonë, (dhe muslimanët janë vëllezër, të moralshëm me njëri-tjetrin, të aftë për të tejkaluar mjegullnatat, drejt rrezeve të diellit), ndonëse rrugët që çojnë drejt rivendosjes së ekuilibrave të humbura që mot, janë të mbushura me inerte, që duhen pastruar me durim! Janë pasojë e shkatërrimit mbi 40 vjeçar të përpjekjeve për të pasur në këtë vend një komunitet besimtarësh muslimanë, të fortë e të shëndoshë, jashtë ndikimeve anësore, në shërbim të plotë të interesave

shpirtërore dhe vlerave kombëtare të këtij vendi të shtrenjtë, ku kemi lindur dhe, ndaj të cilit kemi shumë borxhe!

Nuk është vonë, për të gjetur rrugët e shkrirjes së akujve të krijuar (jashtë vullnetit tonë), nga "të huaj", (ndonëse kanë të njëjtën gjuhë të bukur, si kjo që ne flasim, por që nuk e kanë kuptuar, as do ta kuptojnë, shenjtërinë dhe delikatesën e fesë), të cilët gjatë kësaj kohe kanë abuzuar dhe janë tallur me muslimanët, nëpërmjet "abuzimit" me ndërhyrjet ilegale në trupin e vetë muslimanërisë shqiptare, sepse janë toleruar, jo nga obligimi ndaj tyre, por nga kompromisi i pajustificueshëm!?

Ka ardhur koha, të ndahemi një herë e përgjithmonë nga dëshira, që të shumtë e kanë, për të futur hundët dhe për të dhënë mënyrat e zgjidhjes së "problemeve" të muslimanëve, nëpërmjet kalimit në labirinte të reja, që vetëm se e rëndojnë edhe më shumë këtë realitet dhe e mbajnë akoma peng të jo familjarëve të tij..!?

S' domend, se integrimi evropian i Shqipërisë (me një shumicë muslimane të popullsisë së vet), nuk i shkon për shtat shumë axhendave joshqiptare?! Por, as të zotët e këtyre axhendave, as ithtarët e tyre shqiptarë (me rrobën e "njeriut të ri"), nuk do të arrijnë të kuptojnë se "Shqipëria evropiane", nuk mund të jetë e tillë, pa një performancë origjinale të mendimit islam, (atij, që e udhëhoqi edhe vetë Evropën, për t'u shkëputur nga injoranca, drejt dijes dhe qytetërimit, por që udhëhoqi edhe vetë Shqipërinë, drejt formësimit si shtet, këtu e njëqind e kusur vite më parë), trupëzuar në një institucion të fortë, ndërtohet me duar të natyrshme shqiptare, jashtë influencave të kujtdo dhe, sidomos, jashtë tendencave xhahile të shumëkujt në këtë vend, për të futur duart, këmbët e hundët në brendësinë e tij!

Ndoshta, këto realitete, nuk janë asgjë tjetër, vetëm se një "shkundje" hyjnore, për të na zgjuar nga një



gjendje, në të cilën, thuajse të gjithë u bëmë palë me heshtjen, duke harruar një mirësi të madhe nga Zoti; larminë e shkollave dhe burimeve, në shërbim të një performance më kompakte e më solide, më të aftë për t'u përballur me sfidat e kohës dhe mbi të gjitha, më në gjendje për t'iu përgjigjur interesave kombëtare në rrugëtimet e dallgëzuara, ku më shumë se kurrë nevojitet harmonia largpamëse, shtrëngimi i duarve dhe bashkimi i fuqive për të mirën e një bashkësie sociale model!

Dhe, e tërë kjo, fillimisht, për vetë Shqipërinë, (jo për axhendat e politikave që e mbajtën peng këtë vend dhe i privuan të jetë aty, ku do t'i takonte të ishte; në mesin e popujve dhe kombeve të qytetëruara e në mirëqenie) dhe, për një prezantim dinjitar të Islamit, si feja, që shqiptarët e përqaftuan në paqe me veten, me Zotin dhe tjetrin, duke u dëshmuar shembull i pastërtisë në marrëdhënie me këdo, në rrugën e vëllazërisë dhe harmonisë kombëtare!

Është koha për të dëshmuar bashkërisht vullnetin për t'i shërbyer një kauze të shenjtë e të shtrenjtë: **ruajtjes së vlerave të besimit dhe të fesë, në harmoni të plotë me trashëgiminë kombëtare dhe aspiratës për një të ardhme, të çliruar nga mentaliteti i përjashtimit të tjetrit dhe izolimit nga kushdo ndryshe!**

(Hytbeja e xhumasë, mbajtur, më 21. 3. 2014, në xhaminë e Parrucës)



Hfz. Mehas Alija

Imam në xhaminë "El-Hidaje", Zvicër

Falënderimet dhe lëvdatat më të mëdha janë për Allahun e Madhëruar, Zotin dhe Krijuesin e të gjitha botëve. Selami dhe përshëndetjet tona qofshin edhe për të Dërguarin e Allahut, Muhammedin Alejhisselam, mbi familjen e tij të madhe, mbi shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që jetuan me të vërtetën në zemër.

* * *

“Dhe mos e hani pasurinë e njëritjetrit në mënyrë të palejuar, e as mos u paraqitni me te (me ryshfet) te gjykatësit për të grabitur në mënyrë të padrejtë një pjesë të pasurisë së njerëzve, kur ju e dini (se pa të drejtë po e hani atë).” (El-Bekare, 188).

Të dashur vëllezër, pjesë e besimit të çdo muslimani është që të ushqehet vetëm nga ajo është hallall, dhe t'i largohet tërësisht asaj që është e ndaluar, pra haram. Duke iu përmbajtur këtij rregulli, ne e ruajmë fenë dhe besimin tonë por, njëkohësisht, jemi të garantuar se lutjet dhe dëshirat tona do të jenë të pranuar nga ana e Allahut xh.sh.

Të flasësh në këtë kohë për hallallin dhe për haramin, është më se e nevojshme dhe aktualitet, sidomos kur shohim se si një pjesë e njerëzve pasurohen në mënyrë marramendëse, ndërkohë që shohim shumë të tjerë, të cilët edhe përkundër aftësive dhe mundësive, nuk mund të fitojnë, madje edhe për nevojat e tyre elementare.

Një gjë dihet me siguri, se çdo e mirë materiale i takon vetëm kësaj bote, që do të thotë se, sa do që të arrijmë të fitojmë, atë do t'ua lëmë të

KUJDESI NDAJ HALLALLIT ËSHTË SHENJË E IMANIT

tjerëve. Sidomos duhet pasur kujdes që ato të mira që i arrijmë, të mos i fitojmë përmes rrugëve të haramit, pasi që haramet ndikojnë dhe i asgjësojnë punët e mira. Harami dhe hallalli nuk mund të qëndrojnë së bashku.

Imam Muslimi shënon një hadith të Muhammedit (a.s), i cili thotë: *“Njeriu thotë: O Zot, o Zot. Kurse ushqimi, pija dhe tesha e tij janë të fituar në rrugë të haramit, e si atëherë Zoti t'ia pranojë lutjen”*.

Tregohet se Enes Ibn Malik i kishte thënë Pejgamberit a.s.: *“O i Dërguari i Allahut, lute Zotin që të bëhem nga ata që, gjithmonë, do t'u pranohen lutjet. Pejgamberi i Zotit ia ktheu: “O Enes, bëhu nga ata që fitojnë në formë të drejtë, me hallall, nëse dëshiron që të të pranohet duaja. Me të vërtetë, nëse njeriu e hanë një kafshatë (buke) haram, duaja nuk do t'i pranohet për katërdhjetë ditë.”* (Taberani).

Gjithashtu, transmetohet se ekzistojnë melekë, të cilët për çdo ditë dhe çdo natë, thonë kështu: *“Kushdo që hanë diçka nga harami, Allahu prej tij nuk pranon asnjë farz dhe asnjë sunet.”* (Kebair).

Është e natyrshme që njerëzit t'i shijojnë të mirat e kësaj bote. Kjo kënaqësi, për muslimanët, nuk është e ndaluar, porse duhet të kihet kujdes nga gjërat e ndaluara. Abdullah ibn Omeri (r.a), përcjell se Pejgamberi (a.s), ka thënë: *“Dynjaja është këndshme, prandaj dhe nëse në të fitohet me hallall dhe shpenzohet, gjithashtu, sipas formës së lejuar, Allahu i Madhërishtëm do ta shpërblejë me xhenet. E kush fiton në dynja nga harami dhe shpenzon sipas formës së ndaluar, Allahu i Madhërishtëm do ta dërgojë në shtëpinë e të poshtëruarve.”* (Bejhekiu).

Besimtari duhet që të shtojë kujdesin e tij në lidhje me atë se si e fiton pasurinë. Besimtari duhet të ketë kujdes se si e fiton vendin e punës, apo se si e lartëson pozitën e tij në një

punëtori. Kujdesi duhet të jetë edhe tek ata të cilët fitojnë pensionet. Feja jonë kërkon të jemi të drejtë dhe çdo gjë që e arrijmë në jetë, atë ta bëjmë me hak dhe me hallall.

Edhe studenti, i cili provimet i ka të vjedhura, diplomën nuk e ka hallall. I Dërguari i Allahut (a.s), thotë: *“Kush nuk do të ketë kujdes se si e fiton pasurinë, as Allahu xh.sh., nuk do të ketë kujdes për atë se në ç'nder të xhehennemit do ta fus atë.”* (Kebair).

Të nderuar vëllezër e motra, jemi duke jetuar në një kohë ku njerëzit nuk përfillin kritere dhe vlera. I lakmojmë bamirësit, dhe nuk pyesim se në ç'menyrë e kanë fituar atë pasuri. A mund të fitohet sevap me pasurinë e fituar haram? Një dijetar, Sufjan Theuriu, thotë: *“Kush jep sadaka (lëmoshë) nga pasuria e fituar haram, i ngjanë personit i cili e pastron teshtën me urinën e tij. Teshta pastrohet vetëm me anë të ujit të pastër, sikur që edhe gjynahu pastrohet vetëm përmes hallallit.”* (Kebair).

Sa do që të jetë e gjatë jeta, ajo një ditë do të mbarojë. Andaj dhe për Ahiret duhet të përgatitemi më shumë, pasi që atje do të jetojmë pafundësisht. Për në fund po i theksoj edhe dy hadithe të Muhammedit a.s., në lidhje me këtë temë: *“Më e lëvdueshme është, që dikush prej jush ta mbush gojën e tij me dhé, se sa ta mbush atë me haram.”* (Kebair).


Po ashtu thotë: *“Çdo trup që rritet prej haramit, ai është më afër zjarrit të xhehennemit.”* (Tirmidhiu).

Zoti ynë, na e fuqizo bindjen tonë, që duart nga pasuria e huaj t'i mbajmë larg, ndërsa barqet dhe shtëpitë tona, prej haramit, t'i pastrojmë. Na ndihmo Zoti ynë që t'i qëndrojmë largë asaj që nuk është e jona, ashtu që të jemi sa më afër Madhërisë Tënde.

(Hytbeja e Xhumasë, mbajtur, më 21. 3. 2014 në xhaminë El-Hidaje në St. Gallen të Zvicrës)



المسجد الإسلامي الأثري
دار الإفتاء - مدينة شكوذرة
KOMITETI MYFTINIAE I SHKODËRIT
MYFTINIA SHKODËR



TË XHUMANË
MË 18 DHE 25 PRILL 2014,
NË TË GJITHA XHAMITË
E SHKODRËS!

NDIHMOS PËR XHAMINË TIME!

Kontribo edhe ti!

Dhuro sadopak nga pasuria jote
dhe ndihmo në ndërtimin e xhamive të reja,
lyerjen, mirëmbajtjen e tyre,
blerjen e tapeteve të reja,
(si për xhaminë "Ebu Bekër" dhe Parrucë),
ndërtimin e shumë minareve për xhamitë
që nuk i kanë, si: në Bardhej, Milan/Rrasek,
Xhaferaj, Omaraj, Kala të Drishtit, Drisht etj.

KONTRIBO EDHE TI,
MOS E NËNVLEFTËSO MUNDËSINË
QË TË JEPET!

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Dizajn & Grafik:
Bledar Xama

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

E-mail:
udhaislame@myftinia-shkoder.org
Website:
www.myftinia-shkoder.org